



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1312/3 Prot

Tiranë, më 14.09.2023

VENDIM

Nr. 39, datë 14.09.2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Birn Albania”, përfaqësuar nga z. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1312 Prot., datë 02.08.2023, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (në vijim, “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës datë 06.07.2023, depozituar në adresat elektronike [Besjona.Cenaj@ikmt.gov.al](mailto:Besjona.Cenaj@ikmt.gov.al), [zyraeshtypitikmt@yahoo.com](mailto:zyraeshtypitikmt@yahoo.com) dhe [media@ikmt.gov.al](mailto:media@ikmt.gov.al), referuar zbatimit, nga ana e Autoritetit Publik, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.589, datë 07.09.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

1. *Procesverbalet e verifikimit të shtesave në tejkallim të lejes në ndërtimet në kryeqytet nga viti 2019 deri në 31 mars 2023.*
2. *Raportet dhe dokumentacionin mbi procedurat e ndjekura nga Autoriteti Publik për verifikimin e qëndrueshmërisë së shtesave pa leje dhe vlerësimet konkrete mbi secilin prej ndërtimeve të konfiskuara.*

3. *Raportet e mbajtura nga Autoriteti Publik për rifillimin e punimeve në objektet në të cilat për shkak të konfiskimit ishte bllokuar puna.*
4. *Procesverbale masa administrative ndaj këtyre ndërtimeve si më sipër.*
5. *Kallëzimet penale në prokurori apo polici nga Autoriteti Publik ndaj këtyre ndërtimeve.*
6. *Procesverbalet apo raportet e mbajtura nga Autoriteti Publik për ndërtimet që përfshihen nën VKM-në Nr. 589, datë 07.09.2022 të Këshillit të Ministrave.*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, me shkresën nr. 1312/1 prot., datë 03.08.2023 ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për zotërimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik me e-mail-in datë 14.08.2023, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “*...Paraprakisht vlerësojmë t’ju informojmë se ky infomacion nuk u arrit të jepet brenda afateve ligjore të sanksionuara për shkak se të dhënat e kërkuara nuk administroheshin vetëm nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (në vijim, “IKMT”) por edhe nga IMT vendore e si rrjedhojë në funksion të përgjigjes, IKMT kishte të nevojshëm mbledhjen e infomacionit edhe nga Inspektoratet Vendore – rrethana e cila u bë shkak për tejkalimin e afateve të kthimit të përgjigjes.*”

*Sa lidhet me informacionin e kërkuar, ju parashatrojmë si vijon:*

1. *Sa lidhet me numrin e rasteve të konstatuara në tejkalim të lejes së ndërtimit në ndërtimet në kryeqytet janë gjithsej 9 raste, të cilat janë përfshirë në procedurat e konfiskimit sipas VKM – së Nr. 589, datë 07.09.2022.*
2. *Lidhur me procedurat e ndjekura nga ana e IKMT për verifikimin e qendrueshmerisë së shtesave pa leje dhe vlerësimet për secilin ndërtim evidentojmë se:*
  - *Për secilin prej këtyre rasteve, nga ana e IKMT janë mbajtur e hartuar procesverbalet e konstatimit duke u pasqyruar gjendja e saktë e objektit të konstatuar , matjet, sipërfaqja e plotë dhe ajo në tejkalim të lejes së ndërtimit.*
  - *nga ana tjetër përmes korrespondencës, janë administruar e shqyrtuar të dhëna e dokumentacion zyrtar nga:*

- *Instituti i Ndërtimit i cili ka kryer aktin e ekspertimit lidhur me ndikimin në objekt në rast prishje të shtesës për qendrueshmërinë e tij.*

*Pra, vlerësimi për qendrueshmërinë e objektit e shtesës është dhënë nga organi kompetent i specializuar që është Instituti i Ndërtimit.*

3. *Lidhur me raportet e mbajtura nga IKMT për rifillimin e punimeve, sqarojmë se që në momentin e konstatimit, krahas aktit ku evidentohet konstatimi është nxjerrë dhe urdhëri i pezullimit të punimeve (pa afat) – duke ju komunikuar rregullisht subjektit ndërtues.*

4. *Lidhur me masat administrative ndaj këtyre subjekteve, evidentojmë se:*

- *Sikurse është sanksionuar në pikën 4 të VKM Nr. 589, datë 07.09.2022 subjekti pavarësisht procedurës për konfiskim nuk çlirohet nga detyrimi i pagesës së gjobës së parashikuar nga pika 1, e nenit 52, të ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar.*

- *Si rrjedhojë janë aplikuar sanksionet për dënim me gjobë në referencë të nenit 52, të ligjit nr.107/2014”.*

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesi pretendon se nuk i është vendosur në dispozicion informacioni i kërkuar, pasi nuk ka kërkuar statistika, por dokumente, të cilat përfshijnë procesverbale dhe raporte. Në këto kushte, me e-mail-in datë 14.08.2023, regjistruar me nr. 1312/2 Prot., datë 14.08.2023 ka vijuar me ankimin pranë Komisionerit, duke kërkuar vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 06.07.2023.

Koordinatorja për të drejtën e informimit, pranë Autoritetit Publik, me e-mail-in datë 23.08.2023, ka njoftuar ankuesin se në vijim kjo kërkesë është deleguar për trajtim pranë strukturave kompetente dhe janë në pritje të përgjigjes nga ana e tyre.

Për sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstaton se përgjigja e vendosur në dispozicion nga Autoriteti Publik nuk është në përputhje me kërkesën për informacion datë 06.07.2023, pasi nga ana e ankuesit është kërkuar vënia në dispozicion e dokumentacionit përkatës dhe jo informacion statistikor apo shpjegime lidhur me kryerjen e këtyre procedurave.

Në nenin 2, të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.*

Në kuptim të këtij parashikimi, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të*

shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”

Komisioneri, megjithëse ka mirëkuptuar vështirësitë e hasura për shkak të mbledhjes së informacionit, nuk përjashton në asnjë moment Autoritetin Publik nga detyrimi për të ushtruar veprimtarinë e tij në lidhje me transparencën brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Në nenin 15 të LDI “Afati për marrjen e informacionit” parashikohet se:

“1. Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.....

3. Afati i parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune për një nga shkaqet e mëposhtme:

a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze;

b) nevoja për t’i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;

c)...

Vendimi për zgjatjen e afatit i njoftohet menjëherë kërkuesit.

4. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim.

5. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji.”

Për rrjedhojë, pavarësisht nevojës për t’i shtrirë kërkimet në institucione të tjera, Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik ka patur në dispozicion kohën e nevojshme për të trajtuar kërkesën e paraqitur nga ankuesi.

Për sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se dokumentacioni i kërkuar përmbush në parim kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilit, “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuesit çdo dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit “Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.

LDI ka për qëllim të nxisë përf forcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

## **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankesës së Qendrës “Birn Albania”, përfaqësuar nga z. \_\_\_\_\_, me nr. 1312 Prot., datë 02.08.2023, ndaj Autoritetit Publik “Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 06.07.2023, konkretisht: *(1. Procesverbalet e verifikimit të shtesave në tejkallim të lejes në ndërtimet në kryeqytet nga viti 2019 deri në 31 mars 2023. 2. Raportet dhe dokumentacionin mbi procedurat e ndjekura nga Autoriteti Publik për verifikimin e qëndrueshmërisë së shtesave pa leje dhe vlerësimet konkrete mbi secilin prej ndërtimeve të konfiskuara. 3. Raportet e mbajtura nga Autoriteti Publik për rifillimin e punimeve në objektet në të cilat për shkak të konfiskimit ishte bllokuar puna. 4. Procesverbale masa administrative ndaj këtyre ndërtimeve si më sipër. 5. Kallëzimet penale në prokurori apo polici nga Autoriteti Publik ndaj këtyre ndërtimeve. 6. Procesverbalet apo raportet e mbajtura nga Autoriteti Publik për ndërtimet që përfshihen nën VKM-në Nr. 589, datë 07.09.2022 të Këshillit të Ministrave)*, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 21.09.2023.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallë së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 14.09.2023.

## **KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**